

Klienti:

Bashkia Lezhë

OBJEKTI:

- Ndërtimi i rrugëse “Superstradë – Hidrovor (Tale)” -

RAPORTI TEKNIK

Projekt Zbatimi

Përgatitur nga: **STATENG sh.p.k.**

Tiranë, Shkurt 2022

PËRMBLEDHËSE

1. INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM.....	4
1.1 HYRJE	4
1.2 PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE	4
2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT	12
2.1 VENDNDODHJA	12
2.2 SHITRESAT RRUGORE.....	12
2.3 LLOGARITJA E SHITRESAVE RRUGORE	14
2.4 TROTUARËT.....	17
2.5 BORDURAT DHE KUNETAT.....	17
2.6 PLAN-ORGANIZIMI I PUNIMEVE TË NDËRTIMIT	17
2.7 RRJETI I UJËSJELLËSIT	17
2.8 KANALIZIMET E UJRAVE TË ZEZA	18
2.9 KANALIZIMI I UJRAVE TE SHIUT	18
2.10 SINJALISTIKA RRUGORE	19
2.11 PLANI I PRISHJEVE (INTERFERIMI I TRUPIT TE RRUGES NE ZONAT E RRETHUARA ME GARDHE, MURE RRETHUESE APO OBJEKTE JO-BANIMI) 20	20
2.12 MURET MBAJTËS	20
2.13 URA HD=29M.....	24
2.14 GJELBËRIMI DHE MOBILIMI URBAN.....	28
3. RAPORTI HIDROLOGJIK DHE KLIMATERIK.....	29
3.1 HYRJE	29
3.2 TEMPERATURA E AJRIT	29
3.3 MJEGULLA	30
3.4 RESHJET ATMOSFERIKE.....	30
3.5 BORA.....	31
3.6 LAGËSHIA E AJRIT	31
3.7 STUHITË	32
4. STUDIMI GJEOLGO-INXHINIERIK.....	33
4.1 HYRJE	33
4.2 OBJEKTIVI I PUNIMEVE	33
4.3 NDËRTIMI GJEOLGJIK DHE HIDROGJEOLGJIK.....	33
4.4 DEPOZITIMET E KUATERNARIT	34
4.5 SHKËMBINJTË NEOGJENIKË	34
4.6 KUSHTET HIDROGJEOLGJIKE	34
4.7 REZULTATET E TESTIMEVE	34
5. STUDIMI TOPOGRAFIK.....	41
5.1 HYRJE	41

5.2	PASISJET DHE INSTRUMENTAT E PERDORUR.....	42
5.3	RILEVIMI I BREZIT (FASHA E MATJEVE)	42
5.4	PERSHKRIMI I PUNES NE TERREN	43
5.5	PERSHKRIMI FIZIKO-GJEOGRAFIK I ZONES	43
6.	KONKLUZIONE.....	52
	ANEKSI 1 – TESTET E PROVAVE GJEOLOGJIKE	53

1. INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM

1.1 Hyrje

Bashkia e Lezhës, kërkon të realizojë projektin e zbatimit (studimin dhe projektimin) për objektin: “Ndertimi i Rruges Superstrate - Hidrovor (Tale), në Njësinë Administrative Shënkoll, me vlerë paraprake të ndërtimit 350,000,000 lekë (me TVSH).

Ndërhyrja në këtë zonë me përmirësim të infrastrukturës rrugore synon në një përjasje të integruar të zhvillimit ekonomik, përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve dhe mbrojtjes së ambjentit.

Kjo politikë ka për qëllim ofrimin me cilësi, sipas standardeve bashkëkohore të shërbimeve publike në të gjithë territorin, përmirësimin e cilësisë së shërbimit me ujë, infrastrukturës së kanalizimeve të ujrave të shiut, shërbimit të mbledhjes së mbetjeve urbane dhe përmirësimin e infrastrukturës rrugore.

1.2 Përshkrimi i gjendjes ekzistuese

Rruga shtrihet në Njësinë Administrative Shënkoll, e cila lidh superstraden Lezhe-Tirane me fshatin Rrilë dhe me Hidrovorin e Tales (foto bashkëngjitur). Rruga ka gjatësi rreth 6300 ml. Rruga aktualisht është e shtruar me çakull dhe ka mungesë totale të infrastrukturës. Rruga ka një gjerësi të ndryshueshme nga 3-5 ml. Ajo shtrihet në një terren të pjerrët kodrinor ku më problematike shfaqet pjesa fundore e rruges. Në segmente të ndryshme me kalimin e kohës ka degraduar si rezultat i mungesës së disiplinimit të ujërave të shiut si dhe rreshqitjeve të dherave.

Rruga Superstrate - Hidrovor (Tale)

Kufizime:	Në pjesën jugore nga Rruga e Tales Në pjesën veriore nga Rruga e Barbullojës Në pjesën lindore nga Rruga Lezhë-Shënkoll Në pjesën perëndimore nga Rruga Rrilë-Tale
Gjatësia:	6300 ml
Gjerësia:	3-5 ml
Gjendja aktuale:	Rrugë me stabilizant


Foto të gjendjes ekzistuese nga Rruga Superstrate - Hidrovor (Tale)















2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Realizimi i këtij projekti do të bëhet mbi bazën e standarteve dhe kushteve teknike CNR dhe ato Shqipëtare, si dhe të konsultuara me normat e vendeve të tjera. Projekt zbatimi për objektin Ndertimi i rruges Superstradë-Hidrovat (Tale) është përgatitur në përputhje me Detyrën e Projektimit dhe rekomandimeve të dhënë nga Bashkia Lezhë.

2.1 Vendndodhja

Një paraqitje e përgjithshme e pozicionit gjeografik të objektit “Ndertimi i Rruges Superstrate - Hidrovor (Tale)”, jepet në vizatimin e planimetrik me ortofoto si më poshtë:



Projekt zbatimi i projektuar nga ana jonë dhe i koordinuar me Bashkinë e Lezhës dhe Këshillin Teknik është në përputhje me gjendjen aktuale dhe kërkesat e zonës për urbanizimin e saj dhe kthimin në kushte optimale jetese. Më poshtë jepet përshkrimi i projekt-zbatimit të përgatitur për objektin Ndertimi i Rruges Superstrate - Hidrovor (Tale).

Rrugët janë projektuar duke marrë në konsideratë kryesisht parametrat gjeometrikë ekzistues të zonës në studim, si dhe kufizimeve të tjera në zonë (objekte, shtylla, etj). Është parashikuar ndërtimi dhe rikonstruksioni i plotë i rrjetit rrugor, ndertimi i trotuarit nga njeri krah (majtas), ndertimi i korsise se bicikletave në krahun tjetër (djathtas), ndërtimi i kanalizimeve të ujrave të shiut (KUB), ndriçimit rrugor dhe linjave rezervë.

Rrjeti rrugor është projektuar sipas kërkesave të Detyrës së Projektimit. Në hyrjet, daljet dhe kryqëzimet e rrugëve, të cilat janë në nivel, janë bërë rakordimet përkatëse. Sensi i lëvizjes është bërë me 2 sense lëvizjesh.

2.2 Shtresat Rrugore

Është vlerësuar dhe përcaktuar që shtresat rrugore të ndërtohen tërësisht të reja. Këtë e përforcon akoma më tepër edhe fakti që në trup të rrugës do kryhen një sërë gërmimesh për rrjetet nëntokësore inxhinierike, pra trupi aktual do dëmtohet akoma më tepër.

Nga vlerësimet e formacioneve gjeologjike të trupit të rrugëve dhe intensitetit të trafikut për rrugët që do të projektohen është përcaktuar dimensionimi i shtresave rrugore si më poshtë.

Llogaritja e shtresave rrugore është bërë me metodën CBR, sipas manualeve të AASHTO-s dhe “Pavement Design Catalogue 2001”.

Parametrat për segmentin rrugor në fjalë janë si më poshtë:

Rrugë, Rr. Superstrade - Hidrovor (Tale) (ndërtim i ri):

Dimensionimi i shtresave rrugore:

- Paketa e parashikuar e shtresave (ndërtim i ri):
 - Asfaltobeto + Emulsion Bituminos (0-16 mm) 4 cm
 - Binder + Emulsion Bituminos (0-20 mm) 6 cm
 - Stabilizant (0-40 mm) 15 cm
 - Çakëll (0-60 mm) 30 cm
 - Çakëll (0-100 mm) 80 cm
 - Gjeotekstil 500gr/m²
- Dimensionimi gjeometrik për rrugën:
 - Me gjerësi të gjurmës kaluese + kunetë 6.0m (2x2.5m);
 - Kuneta nga të dy anët me gjerësi 0.5m;
 - Trotuare nga nje anë (majtas) me gjerësi 1.50 m;
 - Korsi bicikletash ne nje ane (djathtas) me gjerësi 2m;
 - Bankine ne nje ane (djathtas) me gjersi variabel sipas hapsirave nga 0 deri ne 1m;
 - Gjerësi të përgjithshme të kurorës së rrugës mesatarisht 10m;
 - Në kthesa është aplikuar zgjerimi i korsive në varësi të rrezes së kthesës, me formulën $e=K/R$, per kthesa me $R \leq 400m$;
 - Shpejtësia e projektuar është 30 km/h, ndërkohë që në afërsi të kryqëzimeve, kthesave, hyrje-daljeve shpejtësia do të jetë 20 km/h.

Kryqëzimi i Fashatit Rrile (prog. 1+050), hyrje dhe ne dalje (prog. 0+000; prog. 6+373.03):

Dimensionimi i shtresave rrugore:


- Paketa e parashikuar e shtresave (ndërtim i ri):
 - Asfaltobeto + Emulsion Bituminos (0-16 mm) 4 cm
 - Binder + Emulsion Bituminos (0-20 mm) 6 cm
 - Stabilizant (0-40 mm) 15 cm
 - Çakëll (0-60 mm) 30 cm
 - Çakëll (0-100 mm) 80 cm
 - Gjeotekstil 500gr/m²
- Dimensionimi gjeometrik për rrugën
 - Me gjerësi të gjurmës kaluese + kunetë 6.0m (2x2.5m);
 - Kuneta nga të dy anët me gjerësi 0.5m;
 - Trotuare nga nje anë (majtas) me gjerësi 1.5 m;
 - Korsi bicikletash ne nje ane (djathtas) me gjerësi 2m;
 - Bankine ne nje ane (djathtas) me gjersi variabel sipas hapsirave nga 0 deri ne 1m;
 - Gjerësi të përgjithshme të kurorës së rrugës mesatarisht 10m;
 - Në kthesa është aplikuar zgjerimi i korsive në varësi të rrezes së kthesës;
 - Shpejtësia e projektuar është 30 km/h, ndërkohë që në afërsi të kryqëzimeve, kthesave, hyrje-daljeve ajo do të jetë 20 km/h.

2.3 Llogaritja e shtresave rrugore

Llogaritja e shtresave rrugore është bërë me metodën CBR, sipas manualeve të AASHTO-s dhe “Pavement Design Catalogue 2001”. Rezultatet e CBR së tabanit të rrugës janë bazuar në testet laboratorike të kryera nga ana e Projektuesit duke i aplikuar një faktor sigurie për të marrë në konsideratë variacionet gjeologjike të zonës.

Shtresat rrugore të projektit janë modeluar si dysheme elastike me tre shtresa. Deformimet dhe forcat në pikat kritike janë llogaritur bazuar në modelin elastik linear. Për të marrë në konsideratë të gjitha aspektet e sjelljes së paketës rrugore, janë konsideruar tre lloje forcash kryesore që shfaqen gjatë përsëritjes së vazhduar të forcave ciklike të trafikut:

- Deformimet vertikale në shtypje mbi shtresën e nën-bazës, e cila mund të shkaktojë deformim të nën-bazës dhe të rezultojë në çedime të përhershme në sipërfaqen e rrugës;
- Forca ose deformime horizontale nën shtresën asfaltike e cila mund të shkaktojë plasaritje dhe dëmtim të thellë të shtresës bituminoze; dhe
- Deformime të dyshemesë në brendësi të paketës asfaltike.



Deformimet brenda paketës asfaltike mund të shmangen duke përbushur kërkesat në Specifikimet Teknike, por trashësia e shtresave granulare dhe bituminoze duhet përzgjedhur duke ndjekur një përjasje analitike në mënyrë që forcat dhe deformimet e krijuara në pikat kritike të jenë brenda normave të lejuara. Sikurse tregohet në figurën më lart, pikat A dhe B janë pikat kritike për deformimet në tërheqje (ϵ_h). Në projektimin e shtresave do të konsiderohet vlera maksimale e deformimit në këto pika. Pika C është vendi kritik i deformimit ϵ_z dhe vendi ku ky deformim arrin vlerën maksimale.

Sipërfaqet bituminoze shfaqin plasaritje në sipërfaqe, në rastet kur vlerat e deformimit në tërheqje tejkalojnë norma të caktuara. Sipas manualeve të AASHTO-s, në projektim janë konsideruar forcat aksiale standarte prej 80kN, e shprehur si çift dy-rrotash, ku secila rrotë ushtron një forcë prej 40kN, me hapësirë aksi 310mm, ndërsa presioni i ushtruar nga goma është konsideruar 0.56 MPa.

Standarti ndërkombëtar AASHTO, bazuar në eksperiencat e mëparshme dhe duke ndjekur një përjasje analitike për projektimin e shtresave rrugore, ka krijuar një seri udhëzimesh për projektimin e rrugëve.

Kjo përfaqëse për projektimin e shtresave rrugore mund të përdoret për shtresa të nën-bazës me CBR nga 2% deri në 10%, si dhe për trafik llogaritës nga 1msa deri në 150msa, duke konsideruar një temperaturë mesatare vjetore të paketës rrugore 35°C. Parametrat e nevojshëm për përfitim të shtresave rrugore janë CBR (përftuar nga testet gjeologjike) dhe llogaritja e intensitetit të trafikut, e cila jepet në vijim.

Vlerat e përfuara më pas interpolohen nga grafikët përkatës, të cilët jepen për intensitet trafikuri prej 1, 2, 3, 4, 5, 10, 20, 30, 50, 100 dhe 150msa. Për intensitete midis këtyre vlerave, pranohet interpolimi linear. Për vlera të trafikut mbi 150msa, mund të përdoren vlerat e përfuara nga grafiku për 150msa, por duke marrë masa shtesë për zgjatjen e jetëgjatësisë së paketës rrugore sipas normave të tjera përkatëse.

Llogaritja e intensitetit të trafikut

Intensiteti i trafikut llogaritet me anë të ekuacionit të mëposhtëm:

$$N = \frac{365 * [(1 + r)^n + 1]}{r} * A * D * F$$

Ku: k = 2, numri i korsive të lëvizjes (pranojmë rrugë me dy sense lëvizjeje)

A = 400, numri i automjeteve në ditë në vitin e parë të përdorimit

r = 2.5%, rritja vjetore e numrit të automjeteve

n = 25, periudha e shfrytëzimit e pranuar nga Projektuesi

F = 2.5, faktori i shkatërrimit për aksin standard, marrë në konsideratë për mjetet komerciale


CBR = 4%, për nënshtresat e bazamentit (provat gjeologjike të realizuar në tabanin e rrugës së projektuar kanë rezultuar me CBR rreth 7%. Nisur nga praktikat ndërkombëtare, është pranuar një vlerë e reduktuar 4% për CBR e tabanit (me ngjeshje ≥ 90% në densitet optimal), supozim i bërë për të marrë në konsideratë dhe ndryshimet lokale gjeologjike që mund të jenë të pranishme përgjatë trupit të rrugës)

D = 0.75, faktori i shpërndarjes së automjeteve


Faktori i shpërndarjes së automjeteve është pranuar D = 0.75, duke iu referuar tabelës së mëposhtme:

Koeficienti i shpërndarjes së automjeteve	Rrugë me një kors k = 1	Rrugë me dy kors k = 2	Rrugë me tre kors k = 3	Rrugë me 4 kors k = 4
D	1.00	0.75	0.55	0.40

Nga sa më sipër, trafiku llogaritës ka vlerën **N = 9.35 msa**.



Dimensionimi i shtresës rrugore, referuar grafikut të treguar më lart, do të ketë një trashësi mbi 700mm. Përbërja dhe trashësia e secilës shtresë është marrë nga interpolimi i grafikëve përkatës nga “Pavement Design Catalogue 2001”.



Referuar interpolimit nga grafikët dhe tabelat e treguara më lart, duke marrë në konsideratë dhe perspektivën dhe gjeologjinë e terrenit, kemi pranuar paketën e shtresave si më poshtë:

Asfaltobeton	4 cm
Binder	6 cm
Stabilizant	15 cm
Çakëll	30 cm
Çakëll	80 cm

2.4 Trotuarët

Pothuaj në të gjithë rrugën do të ndërtohen trotuare për kalimin e këmbësorëve. Trotuarët do të pozicionohen sipas rastit në njërin anë të rrugës. Trotuarët do të jenë tërësisht të rinj me gjerësi që variojnë sipas rëndësisë së rrugës dhe mundësisë së ndërtimit të tyre. Përgjithësisht trotuarët janë vendosur nga ana e objekteve të banimit, majtas në mënyrë që ti shërbejnë sa më mirë banorëve. Ato do shërbejnë për kalimin e këmbësorëve si dhe si bazë për vendosjen rrjetit të ndriçimit rrugor.

Shtresat e ndërtimit të trotuarëve do të jenë:

Shtresë pllaka betoni	6 cm
Shtresë rëre	4 cm
Shtresa nënbaze (çakull ose zhavorr)	15 cm

Shtresat e trotuarit do të ndërtohen mbi trasenë e ndërtuar paraprakisht.

2.5 Bordurat dhe Kunetat

Të gjitha segmentet rrugore do të kufizohen me bordurë betoni M-250 në krahun e rrugës dhe kur është e nevojshme edhe me bordurë fundore. Kunetat do të jenë me gjerësi 50cm dhe do jenë me beton C20/25 me trashësi mesatare 10cm. Kuneta do realizohet me pjerrësi tërthore 10%. Në trup të saj do jenë të ndërtuara pusetat e shiut.

2.6 Plan-Organizimi i Punimeve të Ndërtimit

Para fillimit të punimeve, nga ana e Kontraktorit të përzgjedhur do të paraqitet tek Mbikëqyrësi i objektit Plan-Organizimi për kantierin e ndërtimit. Plan-Organizimi i Punimeve të ndërtimit është i lidhur ngushtë me disponibilitetin e shoqërisë ndërtimore (Kontraktorit) në lidhje me makineritë, fuqinë punëtore, teknologjitë ndërtimore, etj. Gjatë përgatitjes së Plan-Organizimi të punimeve të ndërtimit të merren parasysh Specifikimet Teknike, Grafiku i Punimeve dhe udhëzimet e Projektuesit të dhëna në projekt.

2.7 Rrjeti i ujësjellësit

Në bazë të informacionit të marrë pranë Ujësjellës-Kanalizime Lezhë, rrjeti ekzistues me tub OD 160 PN10 kalon përgjatë rrugës Lezhë-Shënkoll. Rruga e re Superstrada-Hidrovor (Tale) do të ketë një tubacion të ri OD 110. Linja e re e ujësjellësit do të jetë e pajisur me saraçineska izoluese nga rrjeti ekzistues, si dhe janë parashikuar tubat me diametër OD 20 dhe OD 32 për të furnizuar me ujë banorët përgjatë aksit të rrugës së re. Në projekt janë parashikuar hidrantë zjarri, të cilët do të lidhen me rrjetin e ri të ujësjellësit.

2.8 Kanalizimet e Ujrave të Zeza

Përshkrim i gjendjes ekzistuese

Aktualisht në këtë segment rrugor mungon infrastruktura për disiplinimin e ujrave të zeza.

Përshkrimi i projektit të rrjetit të kanalizimit të ujrave të zeza

Pas konsultimeve me Bashkinë e Lezhës, duke qenë se trupi i rrugës është më i ngritur në lidhje me altimetrinë e banesave përfaqë, ky projekt nuk parashikon ndërtimin e infrastrukturës së kanalizimeve dhe ujrave të zeza sepse pozicioni altimetrik i objekteve është më poshtë se niveli i rrugës së projektuar dhe është e pa mundur të funksionoj regjimi i shkarkimit, për këtë arsye shkarkimi i ujrave të zeza për objektet përfaqë do të realizohet nepermjet rrjetit ekzistues të shkarkimeve k.u.z që ka zona, sic ka funksionuar deri tani.

2.9 Kanalizimi i Ujrave të Shiut

Në të gjitha rruget do të ndërtohet sistemi i kullimit të ujrave të shiut. Ai do të përbehet nga kunetat prej betoni C20/25. Kunetat do të kenë gjatësi 0.5m dhe përqendrimin 10%. Në çdo 25m do të ndërtohen puseta shimbledhese me zgara kompozite (40x60cm). Pusetat do të ndërtohen me beton M-200. Kapaket do të jenë kompozite (me menteshe) dhe të prodhuar për ngarkesa të renda. Lidhja midis pusetave do të bëhet me tuba PE të brinjëzuar (korrugato) me D=200 të vendosura poshtë kunetave. Tubat do të vendosen mbi një shtresë rere 10cm dhe do të mbulohen me rere deri 10cm mbi kuroren e tubit.

Mënyra e llogaritjes

Sasia e ujrave të shiut është llogaritur me metodën racionale duke pranuar kohën e perseritshmerisë 1 here në 5 vjet. Vlerat e intensitetit të shiut merren nga lakoret Intensitet – Kohëzgjatje – Perseritshmeri për zonën e Lezhës. Siguria llogaritëse është pranuar 1 here në 5 vjet (20%) duke patur parasysh që çdo pusetë shkarkon individualisht në kanalim që kalon paralel me rrugën.

Rrjedhja kritike (maksimum) e ujrave të shiut në një sistem drenimi i korrespondon periudhës së zgjedhur të perseritjes, mund të llogaritet me:

$$Q = K * i_{tc} * C * A$$

Ku: Q = prurja e ujërave të shiut m³/s
K = faktor i rregullimit të njësive matëse = 0.00278 m³/s
 $i_{tc,TR}$ = intensiteti i shirave mm/h
C = koeficienti i rrjedhjes
A = sipërfaqja e basenit ujëmbledhës ha

Intensiteti i shiut i lexohet në kurbën IDF (intensitet-kohëzgjatje-perseritshmeri) që i korrespondon periudhës së zgjedhur të perseritjes “Tr”. Zgjatja e shiut kritik llogaritet si “tc” që është koha e përqëndrimit të basenit ujëmbledhës. Koha e përqëndrimit është periudha e kohës nga fillimi i rënies së shiut për tërë basenin ujëmbledhës, duke përfshirë pjesën më të sipërme të sipërfaqes që kontribuon në rrjedhje. Për një basen ujëmbledhës të dhënë, “tc” mund të vlerësohet me përafërsi si koha që i duhet pikave të ujit për të lëvizur nga pika më e largët deri në pikën e shkarkimit (aksin llogaritës). Koha totale e llogaritjes përcaktohet si shuma e:

- Koha e përqëndrimit, me supozimin që shpejtësia e rrjedhjes në terren është 1m/s;

- Koha e rrjedhjes ne kanale te vegjel dhe kuneta per nje shpejtesi 1.0 m/s;
- Koha e rrjedhjes ne tubacionet kryesore sipas llogaritjeve paraprakisht 1.5 m/s.

Koefiçienti i rrjedhjes për zonën e marrë në konsideratë do të pranojme $C=0.6$, duke pranuar se sipërfaqja kryesisht është e mbuluar me shtëpi banimi me oborre (shiko vlerat e koefiçientit të rrjedhës në tabelën e mëposhtme).

Lloji i basenit	Vlerat e C
Qytete të sheshtë	0.80-0.90
Rezidenca, shtëpi të ngjitura	0.50-0.60
Rezidenca, shtëpi të larguara	0.10-0.15
Parqe dhe lulishte	0.10-0.15

2.10 Sinjalistika Rrugore

Sinjalistika e rrugës në projekt përfshin sinjalistikën vertikale dhe horizontale. Për shkak të komunitetit dhe objekteve të cilat ndodhen përgjatë të 2 anëve të rrugëve, të cilat kërkojnë akses të vazhdueshëm, sistemi i qarkullimit të rrugëve kryesisht do të trajtohet me dy sense lëvizjeje. Për të gjitha rrugët është hartuar një skemë e plotë qarkullimi.

Sinjalistika Horizontale është e përbërë nga:

- Vija gjatësore (vijëzimet do të bëhen me bojë bikomponente pastë sipas përshkrimit në preventiv, kjo për arsye të jetëgjatësisë sa më të madhe të sinjalistikës horizontale të rrugës);
- Vija tërthore;
- Vendkalime këmbësorësh;
- Shigjeta drejtuese;
- Shkrime dhe simbole;
- Në të gjithë rrugën do të bëhet vijëzimi. Vijëzimi përbehet nga dy vija të pandërprera te vendosura respektivisht në dy anët e rrugës në fund të asfaltit (buzë kunetave) me gjerësi 12cm dhe një vijë e ndërprerë në ndarjen e korsive;
- Shigjetat e drejtimit të lëvizjes, të cilat do të vendosen në çdo korsi dhe para çdo kryqëzimi, për të bërë një orientim sa më të mirë të lëvizjes së mjeteve;
- Cat eyes te kuqe te vendosura te bordura e korsise se bicikletave dhe ne aks te rruges;
- Kufizues shpejtesie terthore per uljen e shpejtesisë.

Sinjalistika Vertikale do të përbëhet nga tabelat, të tipeve si më poshtë:

- Tabelat Detyruese;
- Tabelat Treguese;
- Tabelat Paralajmëruese.

Pozicionet dhe lloji i sinjalistikës horizontale dhe asaj vertikale janë të detajuara në planimetrinë përkatëse. Të gjitha tabelat do vendosen në ane te trotuarit dhe do te fiksohen me beton M-250.

2.11 Plani i Prishjeve (interferimi i trupit te rruges ne zonat e rrethuara me gardhe, mure rrethuese apo objekte jo-banimi)

Në hartimin e këtij projekti është patur prioritet kryesor ruajta e objekteve të banimit. Për këtë arsye objektet jo te banueshme (hangare, stalla, garazhde) që bien mbi gjurmen e trupit te rruges, ne raport me gjatesine totale te rruges se projektuar është relativisht shumë i vogël.

Përgjithësisht preken muret dhe rrethimet aktuale për të krijuar një dimension minimal por unik në çdo segment rrugor. Në raste të veçanta preket ndonjë objekt 1KT hangare, stalla, garazhde të cilat jepen te percaktuara dhe ne planin e pergjithshem te prishjeve.

Në pjesët ku ka heqje/prishje të mureve ekzistuese, projekti parashikon ndërtimin e mureve të reja rrethuese sipas standartit bashkëkohor të vendosur nga Bashkia e Lezhës. Gjatësitë dhe pozicioni i tyre janë paraqitur në planin e prishjeve.

Në bazë të matjeve topografike dhe projektit është hartuar plani përketes i prishjeve. Tabela përmbledhese e prishjeve dhe objekteve që janë në gjurmën e projektit jepet si më poshtë. Në total, sipërfaqet e truallit dhe objekteve që duhen prishur janë:

- Gjatësia e mureve që zënë trupin e rrugës e zënë 352 m

2.12 Muret mbajtës


Mure mbajtës betoni me gravitet me lartësi të variueshme 1m deri në 3m. Muret mbajtës jane vendosur për shkak të disnivelit që ka profili gjatësor i projektur me terrenin ekzistues. Muret mbajtës do të jenë të mbrojtur me guardrail për të plotësuar normat e sigurimit të qarkullimit rrugor.

Muret mbajtës janë të pozicionuar në progresivat si më poshtë, me lartësitë dhe gjatësitë përkatëse:

Llogaritja e mureve mbajtës

Llogaritja e mureve mbajtës është bazuar në teorinë e Coulomb-it për sjelljen e dherave në lidhje me muret, duke pranuar supozimet si më poshtë:

- Dherat janë izotropikë dhe homogjenë, me fërkim të brendshëm dhe me kohezion;
- Sipërfaqja e rrëshqitjes dhe ajo e mbushjes është planare;
- Sipërfaqja e fërkimit është e shpërndarë në mënyrë uniforme përgjatë mbushjes;
- Midis murit dhe mbushjes/dheut ekziston koeficient fërkimi.



Për llogaritjen e mureve mbajtës është llogaritur shtytja aktive, duke përdorur formulën si më poshtë:


$$P_a = \frac{\gamma H^2}{2} \frac{\sin^2(\alpha + \phi)}{\sin^2 \alpha \sin(\alpha - \delta) \left[1 + \sqrt{\frac{\sin(\phi + \delta) \sin(\phi - \beta)}{\sin(\alpha - \delta) \sin(\alpha + \beta)}} \right]^2}$$

Shtytja pasive është llogaritur me formulën:

$$P_p = \frac{\gamma H^2}{2} \frac{\sin^2(\alpha - \phi)}{\sin^2 \alpha \sin(\alpha + \delta) \left[1 - \sqrt{\frac{\sin(\phi + \delta) \sin(\phi + \beta)}{\sin(\alpha + \delta) \sin(\alpha + \beta)}} \right]^2}$$

Muret mbajtës janë projektuar duke marrë në konsideratë këto problematika të qëndrueshmërisë:

- Përmbysje të murit;
- Rrëshqitje në planin e themelit;
- Humbje të qëndrueshmërisë si pasojë e kapacitetit mbajtës të pamjaftueshëm të bazës.



Modelimi i mureve mbajtës është bërë me programin “PROKON 6.2”. Rezultatet dhe llogaritjet e përfuara nga programi janë verifikuar me llogaritje manuale nga ana e Projektuesit. Për llogaritjen e mureve mbajtës, janë pranuar koeficientët e mëposhtëm të sigurisë, sipas EuroCode 2:

- Faktori i sigurisë kundër përmbysjes ≥ 2.0
- Faktori i sigurisë kundër rrëshqitjes ≥ 1.5
- Faktori i sigurisë për kapacitetin mbajtës ≥ 3.0


Në modelimin e mureve mbajtës janë përcaktuar parametrat si më poshtë:


- Ngarkesa mbi materialin mbushës është përllogaritur 16.7 kN/m^2 ;
- Materiali mbushës pas mureve duhet të ketë koeficient fërkimi jo më pak se 35° ;
- Pesha e betonit 25 kN/m^3 ;
- Pesha e dheut mbushës 18 kN/m^3 ;
- Rezistenca në shtypje e betonit $f_c' 20 \text{ MPa}$, sipas markës C16/20;

Të gjithë tipet e mureve janë modeluar dhe llogaritur sipas parametrave të shpjeguar më lart. Me poshtë jepen rezultatet e modelimit për murin mbajtës me lartësi $H=3.0\text{m}$.

FORCES ACTING ON THE WALL AT ULS:
 All forces/moments are per m width

Description	FORCES (kN) and their LEVER ARMS (m)			
	F Horizontal left (+)	Lever arm	F Vertical down (+)	Lever arm
Destabilizing forces:				
Total Active pressure Pa	64.070	1.333	36.888	1.433
As a result of surcharge w	33.967	2.000	19.557	1.433
Stabilizing forces:				
Passive pressure on base Pp	-53.093	0.333		
Weight of the wall + base			100.125	0.976
Weight of soil on the base			36.450	1.639
UDL of 15.0 kPa			17.284	1.475





EQUILIBRIUM CALCULATIONS AT ULS
 All forces/moments are per m width

1. Moment Equilibrium

Point of rotation: bottom front corner of base.

For Overturning moment M_o calculate as follows:

$$M_o = \text{Sum}(\text{hor. forces} \times \text{l.a.}) - \text{Sum}(\text{vert. forces} \times \text{l.a.})$$

For Stabilizing moment M_r calculate as follows:

$$M_r = -\text{Sum}(\text{hor. forces} \times \text{l.a.}) + \text{Sum}(\text{vert. forces} \times \text{l.a.})$$

where l.a. = lever arm of each force.

Stabilizing moment M_r : 200.63 kNm

Destabilizing moment M_o : 72.46 kNm

Safety factor against overturning = $M_r/M_o = 2.769$

2. Force Equilibrium at ULS

Sum of Vertical forces P_v : 188.57 kN

Frictional resistance P_{fric} : 132.04 kN

Passive Pressure on shear key : 0.00 kN

Passive pressure on base : 53.09 kN

=> Total Horiz. resistance F_r : 185.13 kN


Horizontal sliding force on wall F_{hw} : 98.04 kN

Horizontal sliding force on shear key F_{ht} : 0.00 kN

=> Total Horizontal sliding force F_h : 98.04 kN


Safety factor against overall sliding = $F_r/F_h = 1.888$

Dimensionet e mureve mbajtës të projektuar janë si më poshtë, të ndarë sipas lartësive të përcaktuara në projekt 1.0m, 1.5m, 2.0m, 2.5m dhe 3.0m.



2.13 Ura Hd=29m

Ura është pjesë e rrugës "Superstrada-Hidrovor (Tale)". Kjo urë është parashikuar të jetë me hapësira drite, 29 m secila. Mbistruktura do të realizohet me trare kryesore në formë T-je të parapregatitur, të pasnderur me lartësi 1.50m. Seksioni terthor i kësaj ure përfshin 5 trare të parapregatitur, të cilat kanë një distancë mes tyre prej rreth 2,38 m dhe një soletë monolite me trashësi 25 cm.



Mbeshtetjet e trareve të parapregatitur duhet të kenë kuota variabile në mënyrë që të realizohet një sipërfaqe e pjerrët prej 2,5% në pjesën e sipërme të trareve.

Prerja terthore e tij është e përbërë nga 5 trare të pasnderur të parapregatitur dhe soletë lidhëse 25 cm. Traret kryesore lidhen me njëri-tjetrin dhe nepermjet trareve terthore të vendosur në skajet e traut, duke siguruar kështu një punë me të mirë të tyre në drejtimin terthor.

Për llogaritjen e këtij mbikalimi është përdorur programi llogaritës SAP 2000 duke u bazuar në standartet italiane të projektimit të urave.

Llogaritja e ngarkesve

- Ngarkesat nga peshat e shtresave te struktures mbajtese;
- Ngarkesa nga pesha vetjake e mbistruktures dhe te struktures mbajtese;
- Ngarkesa nga presioni i dheut;
- Veprime nga ndryshimet vjetore te temperature;
- Veprime nga ulja e betonit;
- Ngarkesat nga instalimet ne ure, si ujesjellesat, kablllo telefoni, etj.;
- Ngarkesat nga mjetet levizese rrugore;
- Ngarkesat nga turma;
- Forca e frenimit;
- Veprim nga ndryshimi ditor i temperatures;
- Veprim nga ndryshimi i temp. ne mes elementeve te konstruksionit;
- Ngarkesat horizontale terthore nga goditjet e mjeteve te levizeshme;
- Veprimet nga ngarkesat sizmike;
- Grumbullimet e njerezve te lokalizuara ne trotuare ose ne gjeresine kaluese te mjeteve levizese;
- Ngarkesa ndertimore gjate zbatimit (peshat e makinave, njerez, mjete pune, forca qe shkaktohen nga mosndertimi i ekuilibruar sipas skemes stat. etj.

Koeficientet e sigurise per gjendjen kufitare te fundit (SLU)			
Ngarkesa	Koeficienti i sigurise	Kombinimi	
		I zakonshem	Jo i zakonshem
Ngark. permanente			
Jo e favorshme	$\gamma_{G,inf}$	1,35	1
E favorshme	$\gamma_{G,sup}$	1	1
Pres. horiz. i tokes			
Jo e favorshme	$\gamma_{G,inf}$	1,5	0
E favorshme	$\gamma_{G,sup}$	1	0
Pasnderje	γ_P	1	1
C'vendosje	$\gamma_{G,s}$	1	0
Trafiku			
Jo e favorshme	γ_Q	1,5	1
E favorshme		0	0
Aksidentale	γ_A	0	1

Koeficientet e sigurise per gjendjen kufitare te sherbimit (SLE)					
Ngarkesa		Ψ_0	Ψ_0	Ψ_0	Ψ_3
Trafiku	LM	0,75	0,75	0,2	0,8
Ngark Horiz		0	0	0	0
Era	W	0,3	0,5	0	0,6
Temperatura	T	0,8	0,5	0,5	0,8

Metoda llogaritëse:

- Referuar kushtit tone teknik;
- Referuar EuroKodit;
- Referuar Standartit Italian te projektimit te urave;
- Referuar kushtit AASHTO dhe BDS (Bridge Design Specifications).

Define Bridge Section Data - Concrete Tee Beam

Section Data

Item	Value
General Data	
Bridge Section Name	BSEC1
Slab Material Property	CONC
Girder Material Property	CONC
Number of Interior Girders	3
Total Width	11.88
Total Depth	1.7
Slab Thickness	
Top Slab Thickness (t1)	0.28
Fillet Horizontal Dimension Data	
f1 Horizontal Dimension	0
f2 Horizontal Dimension	0
f3 Horizontal Dimension	0
f4 Horizontal Dimension	0
Fillet Vertical Dimension Data	
f1 Vertical Dimension	0
f2 Vertical Dimension	0
f3 Vertical Dimension	0

Units: KN, m, C

OK Cancel

Bridge Section Points for BSEC1

Bridge Section Name: BSEC1

Units: KN, m, C

Section Points

Shape	Point	Material	X	Y
Reference Point			5.94	1.7
Structural Polygon 1	1	CONC	0	1.7
	2		11.88	1.7
	3		11.88	1.42
	4		10.95	1.42
	5		10.45	1.42
	6		8.57	1.42
	7		8.07	1.42
	8		6.19	1.42
	9		5.69	1.42
	10		3.81	1.42
	11		3.31	1.42
	12		1.43	1.42
	13		0.93	1.42
	14		n	1.42

Properties

Base Material	CONC
Axis Angle	0
A	6.0764
d	0.411
r33	1.859
r22	79.4137
I23	0
AS2	3.2733
AS3	3.8935
S33(face)	3.2117
S33(face)	1.6581
S22(face)	13.3693
S22(face)	13.3693
Z33	2.9812
Z22	20.107
r33	0.5199
r22	3.3983
Xcp	5.94
Ycp	1.1212
Xpna	5.94
Ypna	1.3753

OK

General Vehicle Data

Vehicle Name: Auto-D1430

Usage:

- Lane Negative Moments at Supports
- Interior Vertical Support Forces
- All other Responses

Floating Axle Loads:

	Value	Width Type	Axle Width
For Lane Moments	0.	One Point	
For Other Responses	0.	One Point	

Double the Lane Moment Load when Calculating Negative Span Moments

Use BS 5741 (2002) for Uniform Load Length Effects

Vehicle Applies To Straits (Adjacent) Lanes Only

Saddle Reduction Factor: []

Load Plan

Load Elevation


Loads:

Load Length Type	Minimum Distance	Maximum Distance	Uniform Load	Uniform Width Type	Uniform Width	Axle Load	Axle Width Type	Axle Width
Fixed Length	1.5		0	Zero Width		200	One Point	
Leading Load	Infinite		30	Zero Width		0	One Point	
Fixed Length	6		0	Zero Width		200	One Point	
Fixed Length	1.5		0	Zero Width		200	One Point	
Fixed Length	1.5		0	Zero Width		200	One Point	
Fixed Length	6		0	Zero Width		0	One Point	
Trailing Load	Infinite		30	Zero Width				

Add Insert Modify Delete


OK Cancel

Units: KN, m, C



Kombinimet e ngarkesave te marra ne konsiderate jane:

- **COMB1:** Ngarkesat e perhershme + temperaturen;
- **COMB2:** Ngarkesat e perhershme + temp. + pasnderjen;
- **COMB3:** Ngarkesat e perhershme + temp. + pasnderjen + ngarkesat e levizshme;
- **COMB4:** Ngarkesat e perhershme + temp. + pasnderjen + sizmiken ne drejtimin U1;
- **COMB5:** Ngarkesat e perhershme + temp. + pasnderjen + sizmiken ne drejtimin U2.



Ne haze te vlerave te nxjerra nga programi llogarites, behet percaktimi i armatures se pas-nderjes si dhe verifikimet si:

- Per gjendjen kufitare te fundme SLU;
- Per gjendjen kufitare te sherbimit SLE;
- Per fazat konstruktive te ndertimit te objektit.

2.14 Gjelbërimi dhe mobilimi urban

Në të gjithë gjatësinë e projektit, meqenëse trotuaret kanë gjerësi më të vogël se 2m, nuk janë parashikuar pemë. Janë ruajtur pozicionet e VGM ekzistuese dhe në të njëjtën kohë janë parashikuar pozicione të reja për VGM në zonat ku mungonin dhe që preken nga zona në studim. Gjithashtu, janë parashikuar kosha mbeturinash të montuara në shtyllat e ndriçimit rrugor. Pozicionimi përfundimtar dhe përzgjedhja e detajuar e materialeve duhet të koordinohet me Klientin dhe me entet përkatëse gjatë fazës së zbatimit të punimeve.

3. RAPORTI HIDROLOGJIK DHE KLIMATERIK

3.1 Hyrje

Zona ne studim perfshihet ne pjesen jugore te qytetit te Lezhës, qytet që ndodhet në veri-perëndim të Republikës së Shqipërisë.

Në aspektin klimatik zona në studim hyn në nënzonën klimatike fushore qendrore perëndimore ku mbizotëron klima mesdhetare fushore me dimër të butë dhe verë të nxehtë. Temperatura mesatare vjetore varion nga 15°C deri në 16°C. Temperatura mesatare e Janarit varion nga 6°C deri 7°C.


Reshjet mesatare shumëvjeçare janë 1270mm. Shpejtësia e erës në drejtime të ndryshme është nga 1.5 deri 3.0 m/s.

3.2 Temperatura e ajrit

Temperatura e ajrit është një nga elementet kryesor klimatik që shërben për të karakterizuar klimën e një vendi apo një rajoni. Me regjimin mesatar, me ecurinë e saj vjetore e ditore si dhe me vlerat ekstreme, ndikon në strukturat ndërtimore.

Paraprakisht duhet vënë në dukje se gjithë Ultësira Bregdetare gjendet nën ndikimin e fuqishëm të detit Adriatik. Një nga parametrat më të rëndësishëm të temperaturës së ajrit është temperatura mesatare e tij. Për të studiuar shpërndarjen e këtij elementi në zonën në studim si dhe shpërndarjen e tij gjatë vitit, në grafikun me poshte jepen temperaturat mesatare të vendmatjes meteorologjike Lezhë.

Temperaturat mesatare mujore dhe vjetore te ajrit



Përsa i përket luhatjes brenda vitit të temperaturës së ajrit duhet thënë se kemi të bëjmë me një regjim tipik mesdhetar ku temperatura minimale vrojtohet në muajin Janar, 6.9°C, ndërsa temperatura maksimale vrojtohet në muajt Korrik dhe Gusht 23.8°C.

Një parametër tjetër i rëndësishëm i temperaturës së ajrit është edhe temperatura ekstreme e tij (minimale dhe maksimale). Në tabelat me poshte jepen temperaturat minimale dhe maksimale absolute të temperaturës së ajrit për vendmatjen meteorologjike Lezhë.

Për temperaturat minimale është bërë një analizë më e detajuar për vetë kushtet që kërkohen kur bëhen një projekt për rrugën automobilistike. Kështu janë llogaritur ditët me temperaturë negative (të ashtuquajtura ditë të ftoha) për vendmatjen meteorologjike Lezhë.

Për objektin që po studiojmë në zonën tonë, rëndësi paraqesin gjithashtu edhe numri i ditëve me temperature nën -10°C , që quhen ditë të akullta. Në zonën në të cilën shtrihet objekti në studim, temperaturat nën -10°C janë tepër të rralla (rreth 1-2 ditë në vit).

Ditët e ftohta ndodhin gjatë periudhës së ftohtë të vitit (Nëntor-Mars) ku më të shquarit janë muajt Dhjetor dhe Janar, ndërsa ditët me temperaturë nën -5°C janë të rralla.

Në përfundim, përsa i përket temperaturave të ajrit duhet thënë se zona në studim karakterizohet nga një klimë e butë mesdhetare.

3.3 Mjegulla

Mjegulla është ngjarje atmosferike që vështirëson transportin rrugor, detar dhe ajror sidomos kur ka intensitet të madh. Paraprakisht, duhet thënë se mjegulla si fenomen atmosferik është dukuri e rrallë në Shqipëri. Për pasojë edhe zona në studim preket shumë pak nga kjo dukuri.

Mesatarja vjetore më e madhe është 6.1 ditë me mjegull në Lezhë. Në përgjithësi në muajt e stinës së verës në vendmatjen meteorologjike të vendit tonë, mjegulla është një dukuri e rrallë. Nga analizat e materialit të ngjarjeve atmosferike të elementit mjegull për të cilët jepet numri i i ditëve me mjegull, u llogarid edhe koha e zgjatjes së mjegullës. Rezulton se në të gjithë zonën në studim mjegulla zhvillohet pas mesit të natës, rreth orës 2 ose 3 dhe vazhdon deri në orën 9-10 të mëngjesit. Por nuk përjashtohen rastet kur mjegulla zhvillohet në orët e mbrëmjes. Si rregull, në muajt e periudhës së ngrohtë të vitit, mjegulla zhvillohet rrallë dhe në qoftë se ka raste që zhvillohet nuk zgjat shumë kohë.

3.4 Reshjet atmosferike

Reshjet atmosferike janë nga elementët më të rëndësishëm klimatik që përcaktojnë veçoritë klimatike të një zone. Në rastin e projektimit të një rruge veçoritë e reshjeve atmosferike kanë një rol të rëndësishëm sepse kanë të bëjnë me projektimin e sistemit të drenazhimit që lidhet direkt me mirëmbajtjen e rrugës dhe nga ana tjetër lidhet edhe me kushtet e transportit të mjeteve lëvizëse.

Faktorët që ndikojnë në karakteristikat e reshjeve atmosferike janë në pozicionin gjeografik, afërsia me detin dhe orografia. Objekti që po studiojmë shtrihet në pjesën perëndimore të vendit, në Ultësirën bregdetare pranë detit Adriatik me një relief të ulët fushor dhe vargmale që e rrethojnë nga lindja dhe e mbrojnë nga erërat e forta lindore kontinentale. Në tabelën e mëposhtme jepen të dhënat mbi reshjet mujore dhe vjetore.

Konkretisht në zonën në studim, sasia e reshjeve vjetore është rreth 1200mm. Sasia më e madhe e reshjeve ku janë regjistruar 1770mm dhe më e vogla 770mm në vit. Në krahasim me vlerën mesatare të territorit Shqiptar (140mm), kjo zonë është më e ulët në sasinë e reshjeve atmosferike. Siç tregohet në grafikun me poshte shpërndarja e reshjeve gjatë vitit ka një formë “U” që është tipike e një regjimi Mesdhetar të reshjeve. Sasia më e madhe e reshjeve pritet gjatë periudhës së ftohtë të vitit dhe muajt më të lagët janë Nëntor-Dhjetor. Muaji më i thatë është Korriku.

Karakteristikat kryesore të reshjeve

Reshjet intensive në sasi të mëdha për intervale të ndryshme kohëzgjatje dhe sidomos për kohëzgjatjet e mëdha, vrojtohen situata të caktuara sinoptike dhe sidomos ku ciklonet dhe frontet atmosferike janë stacionar. Ato gjithashtu janë të lidhura me llojin e reve dhe të ndikimeve lokale. Duke pasur parasysh sasinë maksimale për 24 orë të reshjeve dhe intensitetin për intervale të ndryshme kohe në periudha të ndryshme kthimi (return periods) zona në studim karakterizohet për intensitete të lartë të reshjeve. Në vendmatjen meteorologjike Lezhë brenda 24 orëve kanë rënë 237.4 mm.

Si ndryshim i ndryshueshmërisë së madhe në kohë dhe hapësirë të reshjeve maksimale 24 orëshe, e domosdoshme është edhe se çfarë sasi reshjesh janë të mundshme gjatë 24 orëve në zonën në studim dhe sa shpesh përsëriten ato. Për këtë qëllim u llogaritën reshjet maksimale për periudha përsëritje të ndryshme. Në tabelën me poshte jepen reshjet maksimale mujore dhe vjetore.

3.5 Bora

Në vendin tonë, në periudhën e ftohtë të vitit, një sasi e konsiderueshme e reshjeve vjen prej borës. Kjo veçori është më e theksuar në zonën malore ku bora është një dukuri e zakonshme. Në zonën në studim bora vrojtohet rrallë dhe mund të konsiderohet si dukuri e jashtëzakonshme. Numri më i madh i ditëve me borë në zonën në studim është rreth 3 ditë në vit.

Në zonën në studim, për shkak të ndikimit zbutës të detit nuk ka kushte të përshtatshme për krijimin e shtresës së borës. Ajo krijohet rrallë, por edhe kur krijohet, nuk qëndron gjatë. Bora krijon shtresë dhe mund të qëndrojë gjatë vetëm në dimra të jashtëzakonshëm të shoqëruar me temperatura negative të ulëta të vazhdueshme.

3.6 Lagështia e ajrit

Si një tregues i rëndësishëm i lagështirës së ajrit shërben lagështia relative e ajrit shërben lagështia relative e ajrit e cila ka një ndikim të drejtpërdrejtë në aktivitetin njerëzor. Në ecurinë vjetore të këtij treguesi vërehen ndryshime që janë kushtëzuara nga qarkullimi stinor dhe relievi. Të dhënat e tabelës se treguar ne vijim se vlerat më të larta të lagështirës relative të ajrit vrojtohen në gjysmën e ftohtë të vitit, gjë që shpjegohet me veprimtarinë ciklonare që vrojtohet në zonën e marrë në studim gjatë kësaj periudhe të vitit.

